REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 670/22
Datë/Datum. 22.12.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 670/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Znj. Kimete Gashi– paneliste individuale, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik N.P.T "Printeks" Naim Shuki B.I –Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma", me nr.të prokurimit: 600-22-10939-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Ndërrmarrja Publike Lokale Prishtina Parking SH.A., me datën 21.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE N.P.T "Printeks" Naim Shuki B.I – Prizren, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 17.11.2022 me numër të protokollit 670/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me uniforma", me nr.të prokurimit: 600-22-10939-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Ndërrmarrja Publike Lokale Prishtina Parking SH.A..

II. **Mbetet në fuqi,** vendimi i AK lidhur me aktivitetin prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij Vendimi.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Me qenë se ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 02.11.2022, Autoriteti Kontraktues – Ndërrmarrja Publike Lokale Prishtina Parking SH.A., ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma", me nr.të prokurimit: 600-22-10939-1-2-1.

Me datën 07.11.2022, OE N.P.T "Printeks" Naim Shuki B.I –Prizren, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK me vendim me datën 08.11.2022.

Me 17.11.2022 OE N.P.T "Printeks" Naim Shuki B.I –Prizren, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 670/22), kundër njoftimit për dhënie të kontratës të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 30.11.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar;

Mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit;

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër arsyetimit të eliminimit të OE ankues N.P.T "Printeks", me tej si parashtruesi ankesës, ku AK- Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking SH.A për mes letrës standard ka cekur se: Nuk keni përmbushur kërkesat e Dosjes se Tenderit; Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale;Nuk keni sjellë Sigurimin e Tenderit

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se parashtruesi i ankesës përmes ofertës si dëshmi për ta mbuluar kërkesën e kualifikimit "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" ka prezantuar listën me gjithsejtë njëzet e pesë (25) kontrata/projekte të përshkruara me vlerë mbi 35,000.00 euro.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se pothuajse të gjitha shitjet OE ankues i ka bërë tek bizneset private, ku faturat janë të vulosura dhe nënshkruara që dëshmojnë se shitja ka ndodhur. Gjithashtu, me tender OE ankues N.P.T "Printeks" ka dorëzuar edhe librin e shitjes të deklaruar në ATK, ku në këtë libër të shitjes vërtetohen faturat e shitjes për të cilat u cek se janë të vulosura dhe nënshkruara.

Meqenëse sektori privat (bizneset) furnizimet apo liferimet (dorëzimi i mallrave) bëhet përmes faturave të cilat deklarohen në ATK për qëllime tatimore, dhe me këto fatura dëshmohet se OE ankues ka kryer liferim (dorëzime të mallrave) te bizneset tjera në shumë mbi 35 mijë euro.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se nëse AK ka pasur dyshime në lidhje me këto fatura dhe librin e shitjes të OE ankues N.P.T "Printeks" ka mundur që ti drejtohet Administratës Tatimore të Kosovës për vërtetësinë e këtyre faturave dhe librin e shitjes. Andaj pretendimi i OE ankues në <u>këtë pikë është i bazuar.</u>

Lidhur pikën e dytë të eliminimit të OE ankues N.P.T. "Printeks" nga ana e autoritetit kontraktues: 2 .Siguria e tenderit . Nuk keni sjelle Sigurimin e Tenderit

Në anën tjetër OE ankues potencon se për shkak të mosfunksionimit të platformës e-prokurimit rrjeti i dobët, siguria e tenderit nuk është ngarkuar në e-prokurim.

Sa i përket arsyetimit të OE ankues se për shkak te mosfunksionimit te platformës e-prokurimit rrjeti i dobët siguria e tenderit nuk është ngarkuar ne e-prokurim, ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues N.P.T "Printeks" Naim Shuki B.I –Prizren, nuk ka bashkangjitur ndonjë dëshmi apo përpjekje duke ju drejtuar KRPP-së për mos funksionim të platformës së e-prokurimit. Andaj pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm.

Përfundimisht, sipas asaj që u përshkrua si më lartë, ekspertja shqyrtuese sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit, kanë ofertuar gjithsej dy (2) operatore ekonomik, andaj kthimi i lëndës në rivlerësim me arsye të sqarimit të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 1 të OE ankues nuk do sillte ndryshim në rezultatin final pasi OE ankues N.P.T "Printeks" nuk e kishte dorëzuar sigurimin e tenderit me ofertë sipas kërkrkesës së dosjes së tenderit siç është përcaktuar në nenin 57 paragrafi 2 të LPP-së.

Duke u bazuar në nenin 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.\

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesuese e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi
mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë,
në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK – Ndërrmarrja Publike Lokale Prishtina Parking SH.A;
1x1 OE- "N.P.T "Printeks" Naim Shuki B.I –Prizren;
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.